VENDIM
Nr.443, datë 16.6.2011

PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT ELEKTRONIK TË ÇËSHTJEVE TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR (ALBIS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", të nenit 26 të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor" dhe të ligjit nr.10 031 datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave "Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor (ALBIS)". Kjo bazë të dhënash përmban:

a) regjistrat e çështjeve aktive të hapura deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe të çështjeve të reja që paraqiten për ekzekutim;

b) dokumentet e punës;

c) dokumente ku evidentohet mënyra e ndërveprimit me institucionet e tjera;

ç) elemente të sigurisë;

d) informacion për proceset e punës;

dh) materiale për instruktim, në ndihmë për përdoruesin e sistemit;

e) ndërfaqe të bazuar në teknologjinë portal;

ë) funksione kërkimi;

f) raportim të statistikave dhe analizave (në dimensione të ndryshme dhe në kohë reale).

2. Përbërësit e arkitekturës *softwa*re dhe *hardware* të sistemit parashikohen në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura në kohë reale dhe që kanë të bëjnë me:

i) çështjet;

ii) dokumentet e punës, ku përfshihen aktet që prodhon përmbaruesi gjyqësor përgjatë veprimtarisë së tij.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e siguruara nga ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave shtetërore dhe kanë të bëjnë me:

i) palët;

ii) të tretët;

iii) të dhëna të vendimeve gjyqësore;

iv) ndërveprimin me institucionet e tjera.

4. Modeli i paraqitjes së të dhënave parësore dhe atyre dytësore parashikohet në aneksin nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Subjektet përgjegjëse të sistemit ALBIS janë, si më poshtë vijon:

a) Institucioni administrues është Ministria e Drejtësisë.

b) Dhënës të informacionit janë:

i) Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;

ii) zyrat vendore të përmbarimit gjyqësor shtetëror nëpërmjet përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë;

iii) Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë;

iv) përmbaruesit gjyqësorë privatë.

c) Subjektet e interesuara dhe niveli i aksesit në bazën e të dhënave për këto subjekte

përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

6. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe procedurat e realizimit të ndërveprimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

7. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara në pikat 5, shkronja “c”, dhe 6, të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha